



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti

Mbledhja nr. 143/2024

Prishtinë, më 1.10.2024, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ferat Shala, kryetar, Jeta Statovci, zëvendëskryetare e parë, Fidan Jilta, zëvendëskryetare e dytë, Mimoza Kusari-Lila, Driton Hyseni, Gramoz Agusholli, Valentina Bunjaku - Rexhepi dhe Pal Lekaj, anëtarë.

Mungoi: Abelard Tahiri, anëtar.

Pjesëmarrës tjerë: Yllka Kllokoqi, KDI; Sami Gashi, Salih Hoxha, GP LVV; Arianit Behramaj, Kuvend; Jeta Huruglica, GP LDK; Festim Bytyçi, GP AAK dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi Ferat Shala, kryetar i Komisionit.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më datë 24.9.2024;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit plotësues me amendamente i Projektligjit nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 24.9.2024

Procesverbali nga mbledhja e mbajtur më datë 24.9.2024, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit plotësues me amendamente i Projektligjit nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues

Kryetari, tha se Komisioni, më datë 23.5.2024, e procedoi për lexim të dytë këtë projektligj, ndërkaq, më datë 9.7.2024, kryesuesja e grupit të punës kërkoi nga Komisioni, që të tërhiqet nga rendi i ditës në seancë, që t'i kthehet Komisionit për konsultime shtesë, për shkak të disa vërejtjeve të OJQ-ve. Me këtë rast, Komisioni e përkrahu propozimin. Po ashtu, më datë 11.7.2024, edhe Kuvendi e përkrahu propozimin e Komisionit. Tani grupi i punës e ka proceduar një draft plotësues të amendamenteve. Në vijim, fjalën ia kaloi znj. Statovci, kryesuese e grupit të punës, për arsyetim të amendamenteve.

Jeta Statovci, tha se në kuadër të ndryshimeve të Projektligjit nr. 08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues, gjithsej janë dy ndryshime, ku njëri amendament i ri, amendamenti 5, dhe një ndryshim teknik tek amendamenti 22. Ajo kërkoi që të hedhet në votim dhe të miratohen këto ndryshime, në mënyrë që të vazhdohet me procedurat tjera për seancë plenare.

Pas debatit, Komisioni, me shtatë (7) vota për, nxori këtë:

REKOMANDIM

- 1. Miratohet raporti plotësues me amendamente i Projektligjit nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues;*
- 2. Raporti procedohet tutje, te komisionet e përhershme, për vlerësim sipas procedurës.*

5. Të ndryshme

Çështjet vijuese

Mbledhja përfundoi në orën 10:40.

E përgatiti: Staf i mbështetës i Komisionit.

Ferat Shala,

Kryetar i Komisionit